



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORE  
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS  
Nr. 930/2 Prot.  
Datë: 01.07.2020

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vlorë, më 16.06.2020

VENDIM


Nr. 74, datë 16.06.2020

PËR  
PROCEDURËN E ANALIZËS SË PYETËSORËVE TË STUDENTËVE PËR  
VLERËSIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE TË  
OFRUARA PREJ STAFIT ADMINISTRATIV DHE NDIHMËSAKADEMIK TË  
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Mbështetur në nenin 38, pika 1, shkronja j, nenin 103, pika 1 në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 80 në Statutin e UV-së, si dhe në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik nr. 51, datë 20.09.2019 për "Miratimin e pyetësorit për studentët për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmësakademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë", Senati Akademik, në mbledhjen e datës 16.06.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmësakademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Procedura e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të përfshijë këto tri faza:
  - a. **Faza e parë:** *Plotësimi i pyetësorëve prej studentëve. Kohëzgjatja: javën e parë të muajit qershor deri në javën e parë të muajit korrik për çdo vit akademik.*
    - Pyetëtori i miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 51, datë 20.09. 2019, në javën e parë të muajit qershor të çdo viti akademik, hidhet në sistemin UVMS, në seksionin e anketimeve, nga Sektori i IT-së të institucionit;
    - Çdo student nëpërmjet llogarisë së tij personale në UVMS plotëson pyetëtorin vetëm një herë. Pyetëtori do të jetë i aksesueshëm për studentët deri në fund të javës së parë të muajit korrik të çdo viti akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK**

- Gjatë gjithë procesit të plotësimit të pyetësorëve, përgjegjësi i Sektorit të IT-së do të ketë akses në rezultatet e pyetësorëve me qëllim monitorimin teknik. Pas përfundimit të procesit të plotësimit të pyetësorëve, përgjegjësi i sektorit të IT-së i përcjell rezultatet e pyetësorëve pranë strukturave përkatëse në Rektorat e dekanate.

**b. Faza e dytë: *Analizimi i rezultateve të pyetësorëve të studentëve. Kohëzgjatja : 2 muaj***

- Brenda një muaji pas përfundimit të plotësimit të pyetësorëve prej studentëve, strukturat e Rektoratit e dekanatet, pasi marrin raportin statistikor të të dhënave, bëjnë analizën e detajuar dhe interpretimin e rezultateve të pyetësorëve së bashku me rekomandimet përkatëse, të cilat ia përcjellin Rektoratit dhe Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional.
- Rektorati dhe Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional përpilojnë raportin e rezultateve të pyetësorëve në nivel institucioni së bashku me rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmësakademik të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Ky Raport i përcillet më tej Rektorit të Universitetit.
- Rektori ia përcjell raportin së bashku me rekomandimet Zv/rektorëve, Dekanëve dhe Administratorit. Këta të fundit e shpërndajnë tek strukturat e varësisë që janë subjekt i këtij pyetësori.

**c. Faza e tretë: *Publikimi & Feedback-u. Kohëzgjatja: 1 muaj***

- Brenda 15 ditëve pas marrjes së raportit të pyetësorëve, drejtoritë dhe sektorët e përfshirë në pyetësor përpilojnë planin e masave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara respektivisht prej tyre, të cilat ia përcjellin më tej sipas varësisë Zv/Rektorëve, Dekanëve dhe Administratorit. Këta të fundit, pas miratimit në parim, i përcjellin për miratim të mëtejshëm pranë Rektorit.
- Rektori, pas miratimit të planeve të propozuara nga çdo drejtori/sector i përfshirë në pyetësor, i përcjell ato pranë Rektoratit dhe Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, të cilët hartojnë planin e masave në nivel institucioni për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit ndihmësakademik dhe administrativ në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
- Plani i masave publikohet dhe iu përcillet për zbatim të gjitha strukturave të përfshira në të.
- NJSBCVI është përgjegjëse për publikimin e raportit të rezultateve të pyetësorëve së bashku me rekomandimet si dhe planin e masave, duke respektuar ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
- NJSBCVI është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të planit të masave dhe raporton tek Rektori për realizimin/mosrealizimin e tij, sipas afateve të përcaktuara në planin e masave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**SENATI AKADEMIK**

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Rektori, Zv/rektorët, Administratori, njësitë kryesore dhe bazë, drejtoritë dhe sektorët në Rektorat, NJSBCVI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

